



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 153, Datë 30.06.2021

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 187, DATË 10.11.2017,
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SH.A. NË AKTIVITETIN E
SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”, I NDRYSHUAR DHE NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-S NR.188, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
ALBGAZ SH.A. NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 12; të neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” nenit 9, pika 1, gërma “d” vi, gërma “e” vi, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e Gazit natyror, miratuar me vendim të bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, si dhe të nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.06.2021, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nr. 96/1 prot., datë 23.06.2021, mbi “Një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për Licencimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe Vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017 “Për licencimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 262, datë 28.12.2020, vendosi:
 1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:
 - “Të licencojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.06.2021, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:
- “Të licencojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.06.2021, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”
 - Dokumentacioni i cili duhet të plotësohet nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. deri më datë 20.06.2021, bazuar në Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e Gazit natyror, miratuar me vendim të bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, sipas vendimeve të bordit të ERE-s nr. 187/2017 dhe nr. 188/2017, të ndryshuara, është si më poshtë:
 - Pajisja me Lejet dhe Autorizimet Mjedisore (neni 9, pika 1, gërma “d”, vi),
 - Depozitimi në ERE i një Certifikatë Sigurimi (neni 9, pika 1, gërma “e”, iv),
 - Në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., nr. 93 prot., datë 21.06.2021, protokolluar në ERE me nr. 764 prot., datë 24.06.2021, “Kthim përgjigje”, nëpërmjet së cilës shoqëria ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar **deri në datën 20.01.2022**, duke u shprehur se ka realizuar “Raportin paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis” dhe është pajisur me “Vendimin për VNM Paraprak”, dokument i cili është i nevojshëm për aplikimin për leje mjedisore, (ky dokument është përcjellë edhe bashkëlidhur kërkesës për shtyrje). **Ky kusht konsiderohet pjesërisht i plotësuar për shkak se shoqëria duhet të depozitojë në ERE Lejen Mjedisore respektive e cila miratohet në vijim të vendimit për VNM Paraprak.**
 - Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citon se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, **ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.**”
 - Në konsideratë të sa më sipër, kërkesa e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 262, datë 28.12.2020 dhe duke marrë parasysh përpjekjet e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për të plotësuar kushtet respektive, vlerësojmë se kërkesa duhet të pranohet dhe afati të shtyhet deri më datë 20.01.2022, për depozitimin në ERE të Lejes Mjedisore, ndërsa për depozitimin e Certifikatës së Sigurimit afati i depozitimit në ERE të shtyhet deri më datë 30.09.2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, si më poshtë:
 - *Të licencojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që:*
 - a. ***brenda datës 20.01.2022, të depozitohet në ERE Lejet dhe Autorizimet Mjedisore.***
 - b. ***brenda datës 30.09.2021, të depozitohet në ERE Certifikatën e Sigurimit.***

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, si më poshtë:
 - *“Të licencojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që:*
 - a. ***brenda datës 20.01.2022, të depozitohet në ERE Lejet dhe Autorizimet Mjedisore.***
 - b. ***brenda datës 30.09.2021, të depozitohet në ERE Certifikatën e Sigurimit.***

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI